



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit  
SP-035  
Prishtinë, më 14, 19, 28 qershor dhe 12, 23, 26 korrik 2018

**PROCESVERBAL**

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 14, 19, 28 QERSHOR DHE 12, 23, 26 KORRIK 2018

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetarët e Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Mufera Srbica-Shinik.

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018.

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Haxhi Avdyli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Albulena Haxhiu, Salih Salihu, Rasim Selmanaj, Zafir Berisha, Islam Pacolli, Besa Gaxherri dhe Nait Hasani, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

**2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti Enver Hoti i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me veprimet e ndërmarra nga kjo ministri për mësimdhënësit me gjendje të rëndë shëndetësore.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Nezir Çoçaj i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me një deklaram të ministrit për reduktimin e universiteteve publike.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Avdullah Hoti i parashtrroi pyetje ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, në lidhje me marrëveshjen e kompanisë publike Posta dhe Telekom i Kosovës, të lidhur me kompaninë Z-Mobile, pas një vendimi të Gjykatës së Arbitrazhit.  
Ministri Valdrin Lluka iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Faton Topalli i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me çmimet e biletave të udhëtimeve ajrore.  
Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Lutfi Zharku i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me një deklaratë të ministrit për disa projektet gjatë kohës kur z. Zharku ishte ministër i Infrastrukturës.  
Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me vonesat për ndërtimin e spitalit pediatrik në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.  
Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Imet Rrahmani i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, në lidhje me kompensimet e pjesëtarëve të policisë për punën shtesë dhe gjatë festave zyrtare.  
Ministri Bejtush Gashi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Bilall Sherifi i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, në lidhje me automjetet e paregjistruara të përfshira në aksidente të komunikacionit.  
Ministri Bejtush Gashi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Ganimete Musliu i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me mundësitë për kyçje të qytetarëve të Vitisë në autostradën Prishtinë - Shkup.  
Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Ganimete Musliu i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me të drejtat e punëtorëve në sektorin privat për pagesat e kontributeve pensionale.  
Ministri Skender Reçica nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Evgjëni Thaçi-Dragusha i parashtrroi pyetje ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, në lidhje me masat e ndërmarra nga kjo ministri pas shqetësimeve të qytetarëve për substanca të dëmshme në lodrat e fëmijëve të importuara.  
Ministri Bajram Hasani iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, në lidhje me ndalesat e qytetarëve në pikat kufitare për shkak të mospagesave të gjobave në komunikacion.  
Ministri Bejtush Gashi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me mosorganizimin e provimit për shoferë instruktorë.  
Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Sami Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me procesin për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës për pensionet e qytetarëve të Kosovës që kanë punuar në Zvicër. Ministri Skender Reçica nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Sami Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje planet e qeverisë për hapjen e një vendkalimi kufitar mes Kosovës dhe Maqedonisë, në Stanaj - Bellanoc, në rrugën Gjilan – Kumanovë (Maqedoni). Ministri Pal Lekaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtrroi pyetje kryeministrit Ramush Haradinaj në lidhje me pezullimin e shqyrtimit të kërkesave të komunave për kthimin e pronave publike të menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në pronësi të komunave. Kryeministri Ramush Haradinaj nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me funksionalizimin e aparaturave të blera nga projekti “Modernizimi i shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinik Universitare të Kosovës”. Ministri Uran Ismaili nuk ishte i pranishëm në seancë.

Kryesuesi i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 13:00, për të vazhduar më 19 qershor 2018.

\* \* \*

*E martë, më 19 qershor 2018*  
*Vazhdim i seancës plenare*

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, procedoi me pikat e papërfunduara më 14 qershor 2018.

Kuvendi, me propozimin e kryetarit të GP të AAK-së, Ahmet Isufi, mbajti një minutë heshtje për vdekjen e babait të kryeministrit të Kosovës, Hilmi Haradinaj.

Pastaj, kryesuesi procedoi me pikat e rendi të ditës, si në vijim:

### **3. Interpelancë me ministren e Integrimit Evropian, znj. Dhurata Hoxha, në lidhje me zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) për kuartalin e katërt (K4) 2017 dhe kuartalin e parë (K1) 2018**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë ministren e Integritimeve, Dhurata Hoxha, lidhur me zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) për kuartalin e katërt (K4) 2017 dhe kuartalin e parë (K1) 2018.

Gjithashtu ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, e paraqiti dhe e arsyetoi çështjen për të cilën është kërkuar interpelanca dhe e propozoi një mocion për miratim. Diskutimi i plotë i z. Hoti është i dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e ftoi ministren e Integritimit Evropian që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me këtë çështje.

Ministrja e Integritimit Evropian, znj. Dhurata Hoxha, e paraqiti qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjen për të cilën është ftuar në interpelancë. Diskutimi i ministres Dhurata Hoxha është dhënë në transkript.

Për interpelancën e ministres së Integritimit Evropian diskutuan deputetët: Ilir Deda, në emër të GP të LDK-së; Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së; Fitore Pacolli, në emër të GP të LVV-së; Shqipe Pantina, në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës Socialdemokrate, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Andin Hoti, Sami Kurteshi, Time Kadrijaj, Milaim Zeka, Hykmete Bajrami, Shemsi Syla, Faton Topalli, Muharrem Nitaj, Nezir Çoçaj, Arbër Rexhaj dhe Rexhep Selimi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në fund të diskutimeve ministrja Dhurata Hoxha dha sqarime shtesë lidhur me debatin e zhvilluar.

Pas këtyre diskutimeve, deputeti Avdullah Hoti, në emër të propozuesit të interpelancës, e paraqiti Propozim-rezolutën lidhur me interpelancën e zhvilluar.

Pastaj, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të kësaj propozim-rezolute shtyhet.

Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca me ministren e Integritimit Evropian është bërë më 28 qershor 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për-----67,  
Kundër-----1,  
Abstenime-----1.

Kuvendi me shumicë votash miratoi këtë:

## R E Z O L U T Ë

1. Në afat prej dy javësh Qeveria të sjellë në Kuvend Programin Kombëtar (të rishikuar) për zbatimin e MSA-së për vitin 2018, i cili merr parasysh vonesat e deritashme.
2. Komisioni Parlamentar për MSA-në dhe Komisioni për Integritim Evropian të shqyrtojë në afat prej dy javësh këtë program me zyrtarët përkatës të Qeverisë dhe t'i paraqesin Kuvendit raport me shkrim, duke identifikuar masat prioritare dhe institucionet përgjegjëse.
3. Pas çdo tremujori, Komisioni Parlamentar për MSA-në t'i paraqesë Kuvendit raport me shkrim lidhur me realizimin e Programit Kombëtar për zbatimin e MSA-së.

4. Të gjitha komisionet parlamentare obligohen të përcjellin punën e dikastereve qeveritare dhe institucioneve të tjera, të cilat ato i mbulojnë lidhur me detyrat e tyre të parapara në Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së.

5. Në afat prej dy (2) javësh Kuvendi të bëjë një plan veprimi për përshejtimin e projektligjeve që lidhen me Agjendën e Reformave Evropiane dhe MSA-në dhe presin për miratim.

#### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet juridike**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar Projektligjin për aktet juridike dhe Kuvendit i ka rekomanduar mosmiratimin e tij.

Në emër të Qeverisë, ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyeoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për aktet juridike diskutuan deputetët: Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit; Korab Sejdiu, në emër të GP të LDK-së; Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së; Shqipe Pantina, në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Sami Kurteshi, Faton Topalli, Fatmir Xhelili dhe Time Kadrijaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

Votimi në parim i Projektligjit për aktet juridike është bërë më 12 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 31,  
Kundër ----- 27,  
Abstenime ----- 10.

Kuvendi mori këtë:

#### **V E N D I M**

Nuk miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-030 për aktet juridike.

Në vazhdim, me propozim të kryetarit të GP të LDK-së, z. Avdullah Hoti, në emër të propozuesve të tri (3) projektligjeve: pikat 5, 6 dhe 7 të rendit të ditës, Kuvendi vendosi që këto pika të shqyrtohen si në vijim:

#### **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale**

**6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave**

**7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për tatimin në vlerën e shtuar**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka shqyrtuar projektligjet e lartshënuara.

Kryetari i GP të LDK-së, z. Avdullah Hoti, në emër të propozuesve i paraqiti dhe i arsyetoi në tërësi përmbajtjet dhe strukturat e tri projektligjeve. Në fund, ai i ftoi deputetët që t'i miratojnë këto projektligje.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtyre projektligjeve.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale; Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për tatimin në vlerën e shtuar, diskutuan deputetët: Lumir Abdixhiku, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Hykmete Bajrami, në emër të GP të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Albin Kurti, në emër të GP të LVV-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të PSD-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi në emër të GP të Partisë Socialdemokrate, Muharrem Nitaj, Milaim Zeka, Ramiz Kelmendi dhe Adem Mikullovc, si dhe ministri i Financave, Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtyre projektligjeve shtyhet.

Votimi në parim i tri projektligjeve nga pikat e rendit të ditës: 5, 6 dhe 7 është bërë më 28 qershor 2018.

*Për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale,*

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 15,  
Kundër ----- 47,  
Abstenime ----- 3.

Kuvendi mori këtë:

**V E N D I M**

Nuk miratohet Projektligji nr. 06/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale.

*Për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave,*

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 19,  
Kundër ----- 44,  
Abstenime ----- 4.

Kuvendi mori këtë:

#### V E N D I M

Nuk miratohet Projektligji nr. 06/L-050 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave.

*Për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për tatimin në vlerën e shtuar,*

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 17,  
Kundër ----- 45,  
Abstenime ----- 4.

Kuvendi mori këtë:

#### V E N D I M

Nuk miratohet Projektligji nr. 06/L-051 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për tatimin në vlerën e shtuar.

\* \* \*

Në vazhdim për fjalë u paraqit deputetja Saranda Bogujevci, e cila e mbajti një fjalim për Ditën ndërkombëtare për eliminimin e dhunës seksuale në konflikte. Fjalimi i deputetes Saranda Bogujevci është dhënë në transkript.

\* \* \*

### **9. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratim e tij.

Pastaj, kryesuesi e ftoi ministrin e Financave, Bedri Hamza, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin.

Ministri i Financave, z Hamza, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi raportin vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Lidhur me raportin vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 diskutuan deputetët: Lumir Abdixhiku, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të GP të LDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Ali Lajçi, në emër të GP të LVV-së dhe Shemsi Syla, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij raporti shtyhet.

Votimi i raportit vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 është bërë më 23 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për----- 60,  
Kundër----- 7,  
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet raporti vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

### **10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratim e tij.

Pastaj kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017.

Lidhur me raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017 diskutuan deputetët: Besa Gaxherri, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe në emër të GP të LDK-së; Lumir Abdixhiku, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Ganimete Musliu, në emër të GP të PDK-së; Shemsi Syla, në emër të GP të LVV-së; Faton Topalli, në emër të GP të PSD-së, Bekim Haxhiu, Gani Dreshaj, Saranda Bogujevci, Arbër Rexhaj, Time Kadrijaj dhe Ali Lajçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij raporti shtyhet.

### **11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2017**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi e ka shqyrtuar raportin vjetor të Këshillit të Kosovës për



Trashëgimi Kulturore për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar mosmiratimin e tij, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratim e tij.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017.

Lidhur me raportin vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017 diskutuan deputetët: Ismajl Kurteshi, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe në emër të GP të LVV-së; Lumir Abdixhiku, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Faton Topalli, në emër të GP të PSD-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së dhe Adem Mikullovc, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij raporti shtyhet.

Votimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017 është bërë më 23 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 12,  
Kundër----- 38,  
Abstenime ----- 17.

Kuvendi mori këtë:

#### V E N D I M

Nuk miratohet raporti vjetor i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017.

### **12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017.

Lidhur me raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017 diskutuan deputetët: Lumir Abdixhiku në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Fatmir Xhelili, në emër të GP të PDK-së; Xhelal Sveçla, në emër të GP të LVV-së; Faton Topalli, në emër të GP të PSD-së; Muharrem Nitaj, në emër të GP të AAK-së dhe Ismajl Kurteshi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij raporti shtyhet.

Votimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017 është bërë më 23 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për----- 55,  
Kundër----- 0,  
Abstenime----- 12.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017.

Pastaj, kryesuesi për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, me pajtimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 18:20 minuta, ndërsa për vazhdimin e saj mbeti të vendosë Kryesia e Kuvendit.

\* \* \*

*E enjte, më 28 qershor 2018*  
*Vazhdimi i seancës plenare*

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, i hapi punimet e vazhdimin të seancës plenare me pikat e papërfunduara më 14 dhe 19 qershor 2018.

Ai procedoi me votimet e projektligjeve dhe raporteve nga pikat e shqyrtuara më 14 dhe 19 qershor 2018.

Kryesuesi konstatoi se për pikat e rendit të ditës: 4, 9, 10, 11 dhe 12 nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe procedimi i votimit të tyre shtyhet.

Pastaj, ai procedoi me pikat e tjera të rendit të ditës si në vijim:

### **8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për miniera dhe minerale dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ai e ftoi kryetaren e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, znj. Sala Berisha-Shala, që ta arsyetojë raportin me rekomandime të këtij komisioni.

Kryetarja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, znj. Sala Berisha-Shala, e arsyetoi raportin me rekomandime të këtij komisioni dhe në emër të komisionit, si propozues i projektligjit, i ftoi deputetët ta miratojnë atë. Diskutimi i plotë i saj është dhënë në transkript.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 45 amendamente.

Kryesuesi procedoi me votimin e amendamenteve të propozuara, por meqë nuk kishte kuorum të mjaftueshme për vendimmarrje, ai tha se votimi i amendamenteve dhe votimi në tërësi i projektligjit shtyhet.

Në vazhdimin e seancës plenare më 12 korrik 2018, kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, lidhur me projektligjin e lartshënuar i njoftoi deputetët se i njëjti hiqet përkohësisht nga rendi i ditës, derisa Agjencia Kundër Korrupsionit ta paraqesë një raport.

### **13. Propozimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, në bazë të Ligjit për Hetim Parlamentar i ka propozuar Kuvendit formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

Më pas, ai i ftoi kryetarët e grupeve parlamentare, të cilat nuk i kanë propozuar më parë që t'i propozojnë deputetët për anëtarë të këtij komisioni.

Grupi Parlamentar i Listës serbe nuk ka propozuar anëtar të këtij komisioni.

Pas propozimeve të anëtarëve nga grupet e tjera parlamentare, kryesuesi e hodhi në votim formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për----- 59,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 2.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

## V E N D I M

*Për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës*

I. Formohet Komisionit Hetimor Parlamentar, me përbërje si në vijim:

1. Mimoza Kusari-Lila,..... nga GP i LDK-së, kryesuese,
2. Dardan Sejdiu, ..... nga GP i PSD-së, zëvendëskryesues,
3. Mirjeta Kalludra,..... nga GP i LDK-së, anëtare,
4. Bekim Haxhiu,..... nga GP i PDK-së, anëtar,
5. Xhevahire Izmaqu, ..... nga GP i PDK-së, anëtare,
6. Liburn Aliu, ..... nga GP i LVV-së, anëtar,
7. Salih Zyba, ..... nga GP i LVV-së, anëtar,
8. Shkumbin Demaliaj, ..... nga GP i AAK-së, anëtar,
9. .... nga GP Lista serbe, anëtar/e,

10. Enver Hoti,.....nga GP i Nismës Socialdemokrate, anëtar dhe  
11. Duda Balje, .....nga GP “6+”, anëtare.

II. Mandati i Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas pikës (I) të këtij vendimi, është i përcaktuar në nenin 6 të Ligjit për Hetim Parlamentar.

#### **14. Propozimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datë 29 mars 2018**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i mbështetur nga 40 deputetë nënshkrues, në bazë të Ligjit për Hetim Parlamentar i ka propozuar Kuvendit formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018.

Pastaj ai e ftoi kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, që ta paraqesë propozimin për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, e paraqiti dhe e arsyetoi propozimin për formimin e këtij komisioni. Diskutimi i tij i plotë është dhënë në transkript.

Në vazhdim, ai i ftoi kryetarët e grupeve parlamentare, të cilat nuk i kanë propozuar më parë, që t’i propozojnë deputetët për anëtarë të këtij komisioni.

Grupi Parlamentar i Listës serbe nuk ka propozuar anëtar të këtij komisioni.

Pas propozimeve të anëtarëve nga grupet e tjera parlamentare, kryesuesi e hodhi në votim formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte:

Për----- 58,  
Kundër ----- 1,  
Abstenime ----- 4.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

#### **V E N D I M**

*Për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018*

I. Formohet Komisionit Hetimor Parlamentar, me përbërje si në vijim:

1. Xhelal Sveçla, ..... nga GP i LVV-së, kryesues,
2. Driton Selmanaj, ..... nga GP i LDK-së, zëvendëskryesues,
3. Anton Quni, ..... nga GP i LDK-së, anëtar,
4. Hajdar Beqa, ..... nga GP i PDK-së, anëtar,
5. Ganimete Musliu, ..... nga GP i PDK-së, anëtare,
6. Sami Kurteshi, ..... nga GP i LVV-së, anëtar,
7. Dardan Molliqaj, ..... nga GP i PSD-së, anëtar,

8. Muharrem Nitaj, .....nga GP i AAK-së, anëtar,
9. ....nga GP Lista serbe, anëtar/e,
10. Haxhi Shala, .....nga GP i Nismës Socialdemokrate, anëtar dhe
11. Bahrim Shabani, .....nga GP “6+”, anëtar.

II. Mandati i Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas pikës (I) të këtij vendimi, është katër (4) muaj.

### **15. Debat parlamentar në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021.

Pastaj, kryesuesi e ftoi kryetarin e GP të LDK-së ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, në emër të parashtruesit të kërkesës, e paraqiti çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar. Diskutimi i tij është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021.

Në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021 diskutuan deputetët: Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Arbërie Nagavci, në emër të GP të LVV-së; Lumir Abdixhiku, Ali Lajçi, Haxhi Avdyli, Shemsi Syla, Vjosa Osmani-Sadriu, Ismajl Kurteshi, Dardan Sejdiu, Enver Hoti, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Bekim Haxhiu, Milaim Zeka, Naser Rugova, Arbër Rexhaj, Ilir Deda, Drita Millaku, Sami Kurteshi, Fatmire Kollçaku dhe Bilall Sherifi, si dhe ministri i Financave, Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në fund të diskutimeve, kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti dha shpjegime shtesë nga debati dhe e propozoi për miratim një propozim-rezolutë tripikëshe.

Në vazhdim, kryesuesi tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të kësaj propozim-rezolute shtyhet.

Votimi i propozim-rezolutës së propozuar nga GP i LDK-së është bërë më 23 korrik 2018.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----29  
Kundër -----47  
Abstenim -----11

Kuvendi nuk e miratoi propozim-rezolutën e propozuar nga GP i LDK-së në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021.

Në fund, kryesuesi i njoftoi deputetët se deputetja Emilija Rexhepi ka njoftuar se i është bashkangjitur Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe aktivitetin e saj parlamentar do ta vazhdojë në atë grup parlamentar.

Kryesuesi i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 18:45.

\* \* \*

*Seanca plenare më 12 dhe 23 korrik 2018 i ka votuar projektligjet, raportet dhe një rezolutë nga pikat e mësipërme të rendit të ditës, vendimmarrja e të cilave është dhënë në fund të pikave përkatëse.*

Ndërsa, më 26 korrik 2018 është vendosur që votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës të procedohet në seancën e radhës.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare më 26 korrik 2018, në orën 11:00.

Kryetari i Kuvendit:  
KADRI VESELI

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*